


SHKURT 2022

BALLKANI I QËNDRUESHËM

GJINIA DHE KRIMI I ORGANIZUAR



FATJONA MEJDINI DHE KRISTINA AMERHAUSER



BALKANI I QËNDRUESHËM

Ky përmbledhje është pjesë e serisë së Iniciativës Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC), Balkani i Qëndrueshëm, që analizon temat me interes për organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) në Ballkanin Perëndimor që merren me çështjet e krimin të organizuar. Ky publikim fokusohet në çështjet që lidhen me gjininë dhe krimin e organizuar dhe shqyrton sesi OSHC-të marrin në konsideratë aspektin gjinor në punën e tyre.

Ky raport u hartua nga Observatori mbi Ekonomitë e Paligjshme në Evropën Juglindore (SEE-Obs), i GI-TOC, dhe Fondi i Qëndresës së GI-TOC. Ky raport bazohet mbi të dhëna, informacione dhe analiza të mbledhura dhe të shpërndara nga aktorët e shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor. Në veçanti, ne duam të falenderojmë Walter Kemp për udhëzimet dhe ndihmën dhe përfituesit në rajon të Fondit të Qëndresës së GI-TOC për përfshirjen konstruktive në këtë proces.

Ne gjithashtu përgëzojmë punën e guximshme dhe të përkushtuar të grave që drejtojnë OSHC-të që merren me krimin e organizuar dhe korrupsionin në Ballkanin Perëndimor.

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Ministrisë së Jashtme Gjermane. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e GI-TOC dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e qeverisë së Gjermanisë.

© 2022 Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë apo material nga ky publikim nuk mund të riprodhohet apo transmetohet në asnjë lloj forme apo mënyre pa miratimin me shkrim nga Iniciativa Globale. Kopertina: © Armend Nimani/AFP nëpërmjet Getty Image; Tingey Injury Law Firm përmes Unsplash

Për çdo informacion shtesë ju lutemi kontaktoni në adresën e mëposhtme:

The Global Initiative Against Transnational Organized Crime

Avenue de France 23

Geneva, CH-1202

Switzerland

www.globalinitiative.net

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIME	2
HYRJE: ROLI I GRAVE NË KRIMIN E ORGANIZUAR	4
GJINIA, NXITËSIT DHE FAKTORËT QË MUNDËSOJNË KRIMIN E ORGANIZUAR	7
QASJET E NDJESHME NDAJ GJINISË NË KUADËR TË LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR NË BALLKANIN PERËNDIMOR	12
ROLI I GRAVE NË OSHC	16
E ARDHMJA	20
SHËNIME	21





GI-TOC organizoi “dialogë për qëndrueshmërinë” në kryeqytetet e vendeve të Ballkanit Perëndimor në vitin 2021. Diskutimet fokusoheshin tek gjinia dhe krimi i organizuar.

PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIME

Në dhjetor të vitit 2020, Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC) mbledhi së bashku më shumë se 50 përfaqësues të shoqërisë civile në një eveniment dyditor në internet, për të diskutuar dhe reflektuar lidhur me sfidat aktuale dhe mundësitë për OJQ-të, mediet dhe komunitetin akademik që merren me problematika që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin.¹ Një prej temave në rendin e ditës ishte edhe “gjinia dhe krimi i organizuar”. Ndonëse në fillim pjesëmarrësit ishin skeptikë dhe njohuritë e tyre rreth ndikimit të gjinisë mbi krimin e organizuar ishin përgjithësisht të pakta, diskutimi ishte i frytshëm. Pjesëmarrësit e vlerësuan mundësinë për të shkëmbyer përvojat e tyre me metodologjitë dhe praktikatat e mira kërkimore. Disa kërkuan që kësaj teme t’i kushtohet më shumë vëmendje dhe që rreth saj të kishte më shumë informacione.

Ky studim pason studimin e politikave “Së bashku jemi më të fortë: Forcimi i qëndrueshmërisë së shoqërisë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor” dhe diskutimin që nisi në takimin e dhjetorit 2020. Gjithashtu, studimi është edhe një reflektim i rritjes së vetëdijesimit të Observatorit të Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore (SEE-Obs) lidhur me zbatimin e perspektivës gjinore në kuadër të punës së tij në fushën e krimin të organizuar. Në këtë studim, në të cilin përdoren shembuj dhe studime rasti nga rajoni, paraqitet perspektiva e shoqërisë civile lidhur me gjininë dhe krimin e organizuar. Autorët dhe hulumtuesit e pranojnë “gjininë” si jobinare dhe e kuptojnë se anëtarët e

pakicave seksuale dhe gjinore mund ta përjetojnë krimin e organizuar në mënyra të ndryshme dhe të reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj tij. Ky studim mbështetet në intervista gjysmë-të strukturuar, diskutime në fokus grupe dhe informacione të mbledhura nëpërmjet anketës në internet, e cila iu dërgua përfituesve të granteve të Fondit të Qëndrueshmërisë të GI-TOC-së në vendet e Ballkanit Perëndimor në nëntor të vitit 2021. Gjithashtu, në studim përfshihen edhe referenca në burime dytësore dhe të dhëna qeveritare aty ku është e përshtatshme. Ekipi kërkimor realizoi një analizë cilësore duke u mbështetur në informacionet e mbledhura, përvojën e tij në rajon dhe rrjetet e tij të personave të kontaktit.

Më poshtë po paraqesim disa rekomandime për shoqërinë civile për të ardhmen:

- Ekziston nevoja për vëmendje më të madhe ndaj rolit që luan gjinia në krimin e organizuar, për të reflektuar rreth perspektivave gjinore dhe ndikimit të tyre në krimin e organizuar gjatë procesit të programimit të veprimtarive në Ballkanin Perëndimor. Në këtë kuadër, ekziston edhe nevoja për t'i kushtuar më shumë vëmendje rolit të paradigëm të tradicionale gjinore në Ballkanin Perëndimor dhe ndikimit që ajo ka në krimin e organizuar.
- Perspektiva e ndjeshme ndaj gjinisë, në Ballkanin Perëndimor, duhet të shkojë përtej vetëm rritjes së përqendrimit të gratë. Perspektiva gjinore duhet të përfshijë ndjeshmërinë ndaj faktorëve nxitës, rolit dhe ndikimit që ka krimi i organizuar në grupe të ndryshme, duke përfshirë pakicat seksuale dhe gjinore, dhe marrëdhëniet e pushtetit midis grupeve gjinore.
- Shoqëria civile duhet të punojë me rol-modelet pozitive në fushën e artit, sportit, biznesit dhe komunitetit dhe me persona ndikues ("influencues") për të krijuar alternativa ndaj rol-modeleve dhe narrativave negative që lartësojnë dhunën, krimin e organizuar dhe mashkullorësinë toksike.
- Shoqëria civile duhet të tregohet kreative me përdorimin e mjeteve siç janë rrjetet sociale me qëllim që të nxisë rritjen e vetëdijesimit gjinor, duke përfshirë këtu edhe kuptimin më të mirë të faktorëve nxitës gjinorë, rolin dhe ndikimin e krimit të organizuar te burrat, gratë dhe pakicat gjinore.
- Ekziston nevoja që OSHC-të në rajon të punojnë së bashku për të shkëmbyer ekspertizën dhe për të ngritur nivelin e informimit rreth praktikave të mira. Udhëzuesit dhe publikimet ekzistuese, siç është raporti i GI-TOC-së, i titulluar "Rethinking Resilience" ("Të rimendosh qëndrueshmërinë") mund të përkthehet në gjuhët vendore dhe të përhapet më tej.²
- Një tjetër mënyrë për të përmirësuar rrjetëzimin dhe shkëmbimin e ideve është krijimi i një koalicioni organizatash të drejtuara nga gratë në media, akademi, sektorin privat dhe OJQ.
- Shoqëria civile duhet të punojë me donatorët për ta bërë fokusin te gjinia jo thjesht "kriter propozimi", por themelin për rritjen e vetëdijesimit për nevojat lokale dhe shndërrimin e tyre në programe të zbatueshme.
- Donatorët duhet t'i ndihmojnë entitetet e shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor që të rrisin kapacitetet e tyre për të përfshirë në punën e tyre problematikat që kanë të bëjnë me gjininë, nëpërmjet moderimit të takimeve rreth kësaj teme dhe nxitjes së kërkimeve ku merret parasysh gjinia.



Gjinia luan një rol kyç në forcimin e qëndresës së komunitetit kundër krimit të organizuar. Në Ballkanin Perëndimor, gratë janë në krye të nismave të shoqërisë civile.

HYRJE: ROLI I GRAVE NË KRIMIN E ORGANIZUAR

Krimi i organizuar në Ballkanin Perëndimor shihet shpesh si “botë burrash”. Kërkimet në fushën e krimit të organizuar janë mbizotëruar nga përqendrimi te burrat si vepruesit kryesorë të sjelljes kriminale. Të pakta kanë qenë hulumtimet lidhur me rolin e grave në krimin e organizuar. Pjesa më e madhe e hulumtimeve ka arritur në përfundimin se gratë pothuaj gjithmonë luajnë rolin e ndihmëseve të burrave dhe, në njëfarë mase, nuk kanë veprueshmëri ose janë vepruese të pavetëdijshme, në kuptimin që vërtet mund të luajnë role, por kjo ndodh për shkak se mashtrohen se gjoja po ndihmojnë familjen e tyre, se nuk kanë zgjidhje tjetër, ose se nuk dinë se ç’janë duke bërë.³

Megjithatë, ta shohësh nga kjo pikëpamje rolin e grave në krimin e organizuar është gjë edhe kufizuese, edhe çorientuese. Gjithashtu, një gjë e tillë nënvlerëson jo vetëm rolin e tyre aktiv brenda rrjeteve kriminale si autore krimi, por edhe si pjesë e komuniteteve ku veprimi i tyre mund të jetë fuqi pozitive për ndryshim dhe qëndrueshmëri. Ky kufizim fokusi ka çuar në krijimin e një hendeku të konsiderueshëm në mënyrën se si kuptohet roli që luajnë gratë si autore krimi, ndikimi që kjo ka në dinamikat e krimit të organizuar dhe rrjedhojat për politikatat dhe reagimet e organeve ligjzbatuese.

Në Ballkanin Perëndimor, diskutimet rreth arsyeve pse njerëzit bëhen pjesë e grupeve të organizuara kriminale zakonisht përqendrohen te të rinjtë (meshkuj) dhe tek ajo se si kombinimi i mashkullorësisë toksike, presionit shoqëror dhe joshjes së stilit të jetës së “pasurimit të shpejtë” i tërheq të rinjtë që

e kanë të vështirë të gjejnë mundësi punësimi në sektorin e rregulluar.⁴ Megjithatë, duhen bërë më shumë kërkime lidhur me faktorët nxitës të krimit të organizuar, duke përfshirë edhe rolin që luajnë gratë si faktorë kriminalë dhe brenda tregjeve kriminale, dhe lidhur me marrëdhëniet e pushtetit midis gjinive.

Gjinia është përcaktuesi kyç i kriminalitetit. Ndonjëherë ajo zë vend më të lart në hierarki sesa statusi social-ekonomik dhe arsimor i një individi ose sesa statusi i individit në lidhje me punësimin.⁵ Gjithashtu, gjinia luan një rol kyç në përcaktimin e viktimave të krimit të organizuar: pothuaj çdo person i trafikuar për shfrytëzim komercial seksual nga Ballkani Perëndimor ose drejt këtij rajoni është femër,⁶ ndërsa pothuaj të gjithë personat e vrarë në kuadër të luftës malazeze të drogës kanë qenë meshkuj.⁷ Përfshirja e perspektivave gjinore në kërkimet shkencore dhe në ligjërimin për temat që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin në Ballkanin Perëndimor kontribuon për t'u dhënë viktimave të krimit të organizuar mundësinë për t'u shprehur.

Në këtë studim tregohet se gjinia luan rol kyç edhe në fuqizimin e qëndrueshmërisë së komunitetit ndaj krimit të organizuar. Në mbarë Ballkanin Perëndimor, gratë janë në frontin e OSHC-ve kryesore që merren me dobësitë që ndërlidhen me krimin e organizuar dhe korrupsionin. Përfshirja e pikëpamjeve të tyre në reagimet e komunitetit është e rëndësishme me qëllim zbutjen e mëtejshme të dukurisë dhe fuqizimin e qëndrueshmërisë.



Imazhet që glorifikojnë maskulinitetin toksik dhe dhunën janë shumë të zakonshme në mesin e të rinjve në Ballkanin Perëndimor.

Foto: Twitter



NJË PERSPEKTIVË GJINORE

Në mbarë botën, gjatë dekadës së fundit, janë rritur ndjeshëm thirrjet për shikimin e zhvillimit përmes lenteve të aspekteve gjinore.⁸ Dalëngadalë, kjo temë ka filluar të tërheqë vëmendjen edhe në Ballkanin Perëndimor. Megjithatë, në këtë zonë të krimit të organizuar, mendimi dhe debati nga media, komuniteti akademik dhe OJQ-të në lidhje me këtë qasje vazhdojnë të mbeten shumë të kufizuara. Ky pohim nuk është i vërtetë vetëm për gjininë si temë që mbulohet nga OSHC-të, por edhe kur është fjala për shkallën e vetëdijesimit të OSHC-ve lidhur me gjininë dhe për mënyrën se si ato i planifikojnë veprimtaritë e tyre.

Autorët dhe hulumtuesit e njohin gjininë si “jobinare” dhe e kuptojnë se anëtarët e pakicave seksuale dhe gjinore mund ta përjetojnë në mënyra të ndryshme krimin e organizuar dhe reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj tij. Megjithatë, duke marrë parasysh risinë e kësaj teme, përfaqësuesit e shoqërisë civile, kur diskutojnë çështjet gjinore, zakonisht u referohen dallimeve midis burrave dhe grave duke u përqendruar më pak te pakicat seksuale dhe gjinore. Në fakt, fjala “gjini”, në këtë kontekst, vazhdon të përdoret thjesht si sinonim për rritjen e përqendrimit të gratë.

Të kesh “perspektivë gjinore” do të thotë të marrësh parasysh aspektet e mëposhtme:

- faktorët nxitës gjinorë të krimit të organizuar, duke përfshirë marginalizimin e grave dhe normat rreth mashkullorësisë, si dhe dobësitë e grave, burrave dhe pakicave seksuale dhe gjinore;
- rolin e grave, burrave dhe pakicave seksuale dhe gjinore, duke përfshirë shtigjet drejt krimit të organizuar;
- ndikimin gjinor të krimit të organizuar, duke përfshirë ndikimin të viktimat e krimit të organizuar;
- përfshirjen e grave, burrave, pakicave seksuale dhe minoritare në shoqërinë civile, qeveri dhe agjencitë mediatike për të punuar në drejtim të trajtimit të krimit të organizuar, duke përfshirë këtu edhe rreziqet gjinore me të cilat përballen në punën e tyre;
- pikat e hyrjes për adresimin e faktorëve gjinorë nxitës, roleve dhe ndikimeve të krimit të organizuar, duke përfshirë fushatat e ndërgjegjësimit, nxitjen e reformave ligjore dhe rolet e grave në OSHC.⁹



Një organizatë e shoqërisë civile në veri të Kosovës punon me të rinjtë për të rritur ndërgjegjësimi për trafikimin e qenieve njerëzore.¹⁰
© Community Building Mitrovica

GJINIA, NXITËSIT DHE FAKTORËT QË MUNDËSOJNË KRIMIN E ORGANIZUAR

Perceptimet lidhur me atë se çfarë është krimi i organizuar dhe kush përfshihet në të, ndikohen në një masë të madhe nga normat sociale, kultura popullore dhe media. Përfshirja në krimin e organizuar priret të pasqyrojë rolet gjinore dhe pritshmëritë e shoqërisë.¹¹ Në Ballkanin Perëndimor, imazhi i krimit të organizuar dhe i personave të përfshirë në të, vazhdon të formësohet nga përjetimet e luftës së viteve 1990 dhe nga tranzicioni i ekonomive dhe shoqërive lokale nga komunizmi drejt demokracisë liberale.¹²

Në gjithë rajonin, imazhi i krimit të organizuar shpesh lidhet me role të fuqishme mashkullore dhe dhunën. Burrat shihen si vepruesit kryesorë, meqë luajnë role qendrore në shoqëri në përgjithësi: ata luftojnë dhe mbajnë familjen. Edhe pse krimi i organizuar kishte kohë që ishte në shumë pjesë të rajoni përpara dhe gjatë luftërave jugosllave, duket se në klimën pas konfliktit, krimi i organizuar u ka ofruar burrave një hapësirë të re ku të ushtrojnë ose rishpallin mashkullorësinë e tyre.¹³

Në Ballkanin Perëndimor, filma si “Scarface” janë të mirënjohur, por e mirënjohur është edhe muzika që ngre në qiell meshkujt “maço” të rinj në formë të mirë fizike, që mbajnë armë dhe që bëjnë jetë materialiste dhe normative për meshkujt.¹⁴ Ndonjëherë ngrihet në qiell edhe kultura e drogës. Huliganët e futbollit që kanë një stil të dallueshëm veshjeje dhe sjelljeje, duke përfshirë edhe dhunën, janë pjesë edhe e identiteteve toksike të grupeve në disa komunitete.¹⁵ Edhe të rinjtë që nuk janë kriminelë priren të imitojnë kodin e veshjes dhe stilin e gangsterëve dhe ngasin vetura të ngjashme.¹⁶ Gratë shpesh portretizohen si aksesore të burrave të fuqishëm dhe seksualizohen ose objektifikohen.

**Intervistat me
gratë të përfshira
në krimin e
organizuar kanë
treguar se faktorët
kryesorë që i kanë
shtyrë drejt botës
kriminale janë
ekonomike.**

Këto imazhe të krimit shpërndahen edhe në mediet sociale dhe në muzikë. Një reper, këngët e të cilit kanë të bëjnë me trafikimin e kanabisit dhe ngritjen në qiell të jetës së krimit, ka 1,6 milionë ndjekës në Instagram. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, profilet e disa kriminelëve të famshëm ose njerëzve që kanë lidhje të ngushta me grupet kriminale, kanë tërhequr secili më shumë se një gjysmë milioni ndjekës.¹⁷

Kjo mënyrë jetese duket ndonjëherë edhe më tërheqëse sidomos kur marrim parasysh përparimin e ngadaltë ekonomik në rajon dhe mungesën e mundësive të punësimit në ekonominë formale, në veçanti në qytetet e vogla dhe fshatrat. Një pjesëmarrës u shpreh: “Fundja, krimi nuk kërkon CV.”¹⁸ Në një mjedis ku mundësitë për punësim të ligjshëm dhe karrierë janë të kufizuara, të rinjtë (meshkuj) raportohet se kërkojnë alternativa, duke u përfshirë në botën e krimit me qëllim që të mbajnë të pacenuar imazhin e tyre burror dhe të përmbushin rolin e tyre si mbajtës të familjes.¹⁹ Gjatë fokus grupeve të organizuara në Shqipëri, të rinjtë raportojnë se bashkimi me grupet kriminale mund të jetë diçka tërheqëse, gjë që do t'i bënte të ndiheshin të fuqishëm, të arrinin një status të caktuar në komunitet dhe të fitonin pasuri që, përndryshe, do ta kishin të pamundur të fitonin. Presioni për të bërë para, i cili përforcohet nga imazhet e lartpërmendura të atyre që janë “të suksesshëm” dhe që shpërndahen në rrjetet sociale, si dhe përballja me realitetin ku mundësitë vendore janë të kufizuara, shërbejnë si faktorë nxitës për të emigruar (në mënyrë të ligjshme ose të paligjshme) gjë që u mundëson atyre “t’ia dalin mbanë” dhe të ndihmojnë familjet në atdhe. Në vendet ku është e pamundur të emigrojnë në mënyrë të ligjshme, të rinjtë marrin përsipër rrezikun dhe shpesh paguajnë shuma të mëdha parash për t’u kontrabanduar.

Intervista me gratë e përfshira në krimin e organizuar kanë treguar se edhe për to faktorët motivues për t’u bërë pjesë e botës së krimit janë edhe ekonomike.²⁰ Një numër indikatorësh kryesorë tregojnë se gratë në Ballkanin Perëndimor përballen me vështirësi ekonomike më të mëdha sesa burrat. Papunësia në rajon është veçanërisht e lartë, sidomos për gratë e reja. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, vetëm 35% e grave ishin të punësuar në vitin 2019, çka është një prej niveleve më të ulëta të punësimit në rajon.²¹ Hendeku gjinor i pagave ishte rreth 10,7% në Shqipëri në vitin 2020,²² 11% në Mal të Zi në vitin 2018²³ dhe 11-16% në Serbi në vitin

2020.²⁴ Gratë që merreshin me kultivimin e kanabisit në Shqipëri raportonin se “punonin 45 ditë për të tharë, pastruar dhe paketuar kanabisin i cili më pas dërgohej në Itali. Sipas njërës prej tyre, “Puna ishte e rëndë, por e kënaqshme. Për tetë orë pune, paguheshim 2 000 lekë [16 euro] dhe po të punonim dhjetë orë, mund të fitonim 2 500 lekë [19 euro]. Me paratë që fitova, u bleva fëmijëve rroba dhe librat e shkollës.”²⁵ Ndonjëherë, ato e shihnin përfshirjen e tyre në prodhimin e kanabisit si punë bujqësie dhe jo si krim të organizuar.²⁶




FIGURA 1 Të dhëna për papunësinë në Ballkanin Perëndimor, 2019.

Burimi: Platforma “Open Data” e Bankës Botërore

Shoqëritë në Ballkanin Perëndimor po ndryshojnë me shpejtësi. Kjo shihet edhe në mënyrën se si perceptohet roli i grave. Një tregues i këtij ndryshimi është norma në rritje e divorceve. Sidomos në kryeqytete dhe në zonat urbane, gratë po fuqizohen më shumë dhe mbajnë poste të larta në politikë, institucione qeveritare dhe në sektorin privat.²⁷ Paralelisht me këtë, edhe roli i grave në krimin e organizuar dhe mënyra se si perceptohen ato mund të ndryshojë me fuqizimin e mëtejshëm të grave në rajon dhe me përshkallëzimin e rolit të tyre. Në thelb, ndërkohë që gratë marrin role më aktive në sektorin formal, ato marrin role më aktive dhe madje drejtuese në ekonominë kriminale.




FIGURA 2 Norma e divorceve në Ballkanin Perëndimor.

Burimi: Eurostat, Norma bruto e martesave dhe norma bruto e divorceve, marrë nga: <https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/tps00206/default/table?lang=en>.

Një shembull: gratë nga Ballkani Perëndimor kanë qenë pjesë e “Panterave Rozë”, një grup famëkeq hajdutësh nga Mali i Zi, të cilët ishin aktivë në mbarë Evropën në fillim të viteve 2000.²⁸ Ka edhe raportime për gra që drejtojnë grupe të organizuara kriminale që merren, për shembull, me kultivimin e kanabisit në Spanjë²⁹ dhe si rekrutuese punonjësesh të seksit.³⁰ Në fakt, në vitin 2020 ka pasur disa raste ku gratë në Ballkanin Perëndimor u akuzuan për lehtësim dhe ndërmjetësim të punës së seksit.³¹

Të tjera gra mbështesin menaxhimin e biznesit kriminal të familjeve të tyre. Gjithashtu, ato supozohet se përfshihen edhe në pastrimin e parave të meshkujve të familjeve të tyre, siç tregohet nga një hetim i kohëve të fundit nga Prokuroria Serbe për Krimin e Organizuar të një gruaje të një kriminelit të njohur serb.³² Nga intervistat është lënë të kuptohet se gratë përfshihen në kontrabandimin ndërkufitar të llojeve të ndryshme të mallrave të paligjshëm, veçanërisht sepse ato kanë më pak të ngjarë sesa burrat që të kontrollohen nga policia dhe rojet kufitare të sigurisë.³³ Në vitin 2019, një aktore nga Maqedonia e Veriut u arrestua për lehtësimin e kontrabandimit të 700 kilogramëve kokainë në Spanjë në emër të partnerit të saj dhe për ujdishjen e transfertave bankare.³⁴

Ndryshimi i rolit të grave në krimin e organizuar mund të vihet re edhe në mediet sociale, ku disa kanë postuar për “arritjet” e tyre dhe fitimin e shpejtë të parave (të paligjshme) dhe ku nxisin vlera të ngjashme ashtu siç nxisin burrat që merren me këtë biznes.

Pavarësisht rritjes së përfshirjes së grave në krimin e organizuar, numri i grave të arrestuara për krime të tilla vazhdon të mbetet i vogël. Për shembull, nga të gjithë personat e arrestuar në Bosnjë dhe Hercegovinë në vitin 2020, vetëm 7,2% ishin gra.³⁵ Më pak se 5% e të burgosurve në të

gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor janë gra. Midis viteve 2012 dhe 2018, nga të gjithë personat e dënuar për përfshirje në grupet e krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor, vetëm 7% ishin gra.³⁶ Numri është i ulët, sidomos për veprat penale të trafikimit të drogës.³⁷ Megjithatë, në mënyrë përpjesëtimore, duket se ka një përqindje më të lartë të grave që dënohen për lloje të tjera të krimeve të rënda, siç është mashtrimi.³⁸

Ndonëse, jepet përshtypja se krimet që kryhen nga gratë janë më pak të dhunshme sesa rastet që kryhen nën drejtimin e burrave, është e rëndësishme të mbahet parasysh që perceptimet gjinore formësojnë jo vetëm rolin që luajnë individët në krimin e organizuar, por edhe reagimet e agjencive të zbatimit të ligjit dhe modelet e ndërhyrjes së tyre. Thënë ndryshe, perceptimet tradicionale që kanë zyrtarët e zbatimit të ligjit mund të ndikojnë në paragjykimin e prirjes së tyre për të shpërfillur rolin e mundshëm të autoreve (femra) të veprave penale. Për këtë arsye, mund të jetë e vërtetë që popullata e personave të burgosur dhe statistikave zyrtare japin një pasqyrë të deformuar të panoramës kriminale të vërtetë në Ballkanin Perëndimor.

Gjithashtu, ia vlen të vihet në dukje se pavarësisht rolit të shumanshëm që luajnë gratë në krimin e organizuar në mbarë rajonin, përfaqësuesit e intervistuar të shoqërisë civile nuk u vishnin asnjë përgjegjësi grave të përfshira në krimin e organizuar, duke pasqyruar në këtë mënyrë perceptimin tradicional të roleve të grave në shoqëri.




FIGURA 3 Popullata e personave të burgosur sipas gjinisë në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Serbi (2020), Kosovë³⁹ (2021) e shprehur në përqindje.

Burimet: Të dhënat janë ofruar nga Ministria e Drejtësisë e Bosnjës dhe Hercegovinës; Marcelo F Aebi dhe Mélanie M Tiago, Prison populations [Popullatat e burgjeve], Space I – 2020, Këshilli i Evropës, 15 dhjetor 2020, https://wp.unil.ch/space/files/2021/04/210330_FinalReport_SPACE_I_2020.pdf; A e dini sa meshkuj e sa femra në Kosovë aktualisht ndodhen nëpër burgje?, Syri, 11 maj 2021, https://www.syri.net/syri_kosova/lajme/249905/a-e-dini-sa-meshkuj-e-sa-femra-ne-kosove-aktualisht-ndodhen-neper-burgje/; Ženski zatvori u BiH imaju problema s kapacitetom, Vijesti, 11 nëntor 2019, <https://www.bljesak.info/vijesti/flash/zenski-zatvori-u-bih-imaju-problema-s-kapacitetom/291600>.



Neostart, një organizatë e shoqërisë civile me bazë në Beograd, Serbi, po punon për të ndërtuar një program të riintegrit të femrave pas burgut.

© Neostart

QASJET E NDJESHME NDAJ GJINISË NË KUADËR TË LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Sikurse kemi treguar në pjesën e mëparshme, burrat dhe gratë preken nga krimi i organizuar dhe reagojnë ndaj tij në mënyra të ndryshme.⁴⁰ Kjo gjetje u konfirmua edhe nga përfaqësuesit e OSHC-ve të intervistuar për këtë raport.⁴¹

Megjithatë, deri më tani, i paktë ka qenë përqendrimi te mënyra se si e merr parasysh gjininë shoqëria civile gjatë procesit të formësimit të reagimeve të saj ndaj krimit të organizuar.⁴² Duke kuptuar më mirë aspektet gjinore të qëndrueshmërisë ndaj krimit të organizuar, do të përmirësohej efektiviteti i përkrahjes që u jepet organizatave komunitare. Mosmarrja parasysh e faktorëve gjinorë gjatë hartimit të programeve të qëndrueshmërisë së komunitetit mund t'i ekspozojë gratë ndaj rreziqeve dhe dobësive më të mëdha dhe të përjetësojë ose përkeqësojë pabarazitë.⁴³

Është interesant fakti që, edhe pse pjesa më e madhe e të anketuarve (shihni “Përmbledhjen” më sipër) besonin se në qasjen e tyre gjinia merrej parasysh ose se qasja e tyre ishte, madje, e ndjeshme ndaj gjinisë, kjo nuk pasqyrohej gjithmonë në misionin e organizatave të tyre ose nuk përfshihej në

propozimet për projekte për veprimtari të reja.⁴⁴ Disa përgjigje të përfaqësuesve të shoqërisë civile pasqyrojnë perceptimet tradicionale të grave në shoqëri, ku dikush u shpreh madje se “i përfshijnë referencat në gjini për shkak të kërkesave të donatorëve”.⁴⁵ Të tjerë të anketuar argumentonin se “meqë punojnë me gra, nuk është e nevojshme të ndjekin asnjë qasje të ndjeshme ndaj gjinisë”.⁴⁶ Kjo lë të kuptohet se, edhe në radhët e aktivistëve të shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor, gjinia shpesh shihet si një çështje e të qenët “politikisht korrekt”, e cila shënohet në propozime projektsh vetëm sa për t’u bërë qejfin donatorëve dhe jo si diçka që vërtet është e nevojshme për të trajtuar problemet reale, duke përfshirë këtu edhe sjelljen seksiste.

Megjithatë, edhe pse shumë aktivistë të organizatave nuk e përmendin zyrtarisht gjininë në aktivitetet e tyre dhe kanë pak përvojë në hartimin e projekt-propozimeve të informuara për gjininë, shumë i zbatojnë këto parime në praktikë. Shumica e organizatave që merren me rininë kanë projekte për aktivitete të ndryshme për të rinjtë dhe të rejat dhe ofrojnë edhe nisma me të cilat synohet të mbledhen rreth së njëjtës tavolinë grupe të ndryshme sociale. Për shembull, klubi “Vllaznia Tae Kwon Do” në Shkodër të Shqipërisë kërkon vazhdimisht që të rejat të marrin pjesë në kurset e arteve marciale që ofron klubi, edhe si studente, edhe si trajnere.⁴⁷

Klubi “Masa” në Mostar të Bosnje dhe Hercegovinës organizon takime në fokus grupe lidhur me temën e huliganizmit ku marrin pjesë rregullisht të rinjtë e të rejat. Edhe pse huliganizmi është, në vetvete, çështje “mashkullore” (asnjë grua nuk është regjistruar si huligane në zonën e Mostarit), klubi vuri re se mbledhja e grupeve për të diskutuar së bashku përmirësonte mënyrën se si kuptohet dukuria dhe sjellë ide të reja lidhur me hapat e mundshëm që duhen ndjekur në të ardhmen.⁴⁸

Ideja e mbledhjes bashkë të burrave dhe grave është e rëndësishme. Siç u shpreh një pjesëmarrës në një takim në fokus grup: “Në shumë zona rurale dhe nënurbane, jeta e të rinjve dhe të rejave duket se shkon paralel. Duke qenë se nuk ka aktivitete sociale, mundësitë që ata kanë për t’u takuar me njeri-tjetrin pas shkolle janë të pakta.”⁴⁹ Një pjesëmarrës tjetër në një takim në fokus grup tha: “Burrat shkojnë në bare ose pika bastesh ose ngasin makinat nëpër qytet, ndërsa gratë shpesh shkojnë në kurse private ose takohen në shtëpitë e njëra-tjetrës. Mundësitë për ndërveprim janë të pakta.”⁵⁰ Gjatë një fokus grupi të organizuar në Shqipëri në nëntor të vitit 2020, të rinjtë refuzuan të merrnin pjesë në diskutim ku kishte gra sepse ata nuk marrin pjesë në “aktivitete grash”.

Në disa raste, OSHC-të merren edhe me stereotipat, me qëllim që të ndërtojnë ura dhe të përfshihen në dallimet gjinore. Për shembull, një OJQ që punon me të rinjtë për të parandaluar përdorimin dhe shpërndarjen e drogës në pjesët rurale të Maqedonisë së Veriut raportonte se përdorte tema si moda për të motivuar vajzat që të merrnin pjesë në veprimtaritë e organizatës dhe sportin për të motivuar djemtë. Puna me programet e tipit “nga kolegu/shoku te kolegu/shoku” (“peer-to-peer”) është tepër e rëndësishme sepse të rinjtë mund të gjejnë veten e tyre me përjetimet dhe përvojat që tregojnë njerëzit e tjerë që kanë të njëjtën moshë si ata (ndryshe nga

mësuesit ose të rriturit). Në këtë mënyrë, OSHC-të janë në gjendje të përfshijnë edhe rastet “e vështira”. Veprimtaritë e tipit “nga kolegu/shoku te kolegu/shoku” ndihmojnë edhe në “shndërrimin e informacioneve të papërpunuara në njohuri të dobishme”.⁵¹



RIINTEGRIMI I NDJESHËM NDAJ GJINISË PAS KRY- ERJES SË DËNIMIT ME BURG NË SERBI

Një shembull i mirë i krijimit të reagimeve të ndjeshme ndaj gjinisë kundër krimit të organizuar vjen nga Serbia ku një OSHC punon për parandalimin e krimit dhe synon të zvogëlojë dobësinë ndaj recidivizmit, duke mbështetur ish-autorët e veprave penale në përpjekjet e tyre për t'u riintegruar. Deri më tani, organizata “Neostart” me seli në Beograd, ka punuar kryesisht me burrat, në mënyrë individuale dhe në grupe, meqenëse përpjekjet e tyre të mëparshme për t'i nxitur gratë që të marrin pjesë në programin e organizatës dështuan. Edhe pse gratë tregonin interes në fillim për aktivitetet e organizatës (tani për tani, në Serbi ka rreth 220 të burgosura), ato e linin programin.

E habitur nga ky reagim, organizata “Neostart” filloi të hulumtonte shkaqet e mundshme dhe gjeti se gratë e liruar nga burgu ose institucionet korrektuese për të rinjtë kanë nevojë që ndryshojnë nga nevojat që kanë burrat. Një anëtar i organizatës “Neostart” u shpreh: “Gratë rrallë vijnë për nevojë bazë p.sh. ushqime, para ose strehim, sepse gjejnë një mënyrë a një tjetër për të siguruar para dhe janë të mbuluara. Por ato kanë nevojë të tjera dhe iu duhet mbështetja për të gjetur punë.”⁵² Gratë e liruar nga burgu duket se vuajnë më pak nga varësia ndaj drogës sesa burrat.

Duke u mbështetur në këto vëzhgime, Neostart-i ka marrë një qasje të re: përmes një programi që drejtohet tërësisht nga gratë, për gratë, duke përfshirë mbështetje nga një psikologe e cila hartoi seanca të veçanta që përqendrohen tek artet ekspresive dhe fuqizimi i lidhjeve me familjarët e ish-të dënuarave.⁵³

Një shqetësim kryesor për shoqërinë civile është puna me gratë viktime të krimit të organizuar dhe sidomos me viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Dhuna ndaj grave vazhdon të mbetet shqetësim madhor. Në vitin 2019 në Serbi, më shumë se 60% e viktimave të abuzimit dhe torturës ishin gra.⁵⁴ Në vitin 2020, 86% e të gjitha viktimave të krimeve seksuale në Shqipëri ishin gra,⁵⁵ ndërkohë që, në Bosnjë dhe Hercegovinë, një në tri gra raportohet se është viktimë e dhunës.⁵⁶ Një studim i hartëzimit të OSHC-ve në Ballkanin Perëndimor tregon se ka OJQ që u ofrojnë ndihmë specifike grave (dhe fëmijëve të tyre) të cilat vuajnë si pasojë e dhunës së burrave ose që janë viktime të trafikimit të qenieve njerëzore. Shumë prej tyre organizojnë seanca këshillimi dhe u ofrojnë grave strehim, ndërsa OJQ të tjera ofrojnë shërbime telefonike të drejtpërdrejta dhe këshillim për burrat.⁵⁷

Në Ballkanin Perëndimor, një prej sfidave kyçe për shoqërinë civile, të identifikuar në raportin “Së bashku jemi më të fortë: Forcimi i qëndresës së shoqërisë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor”, ngrihej vazhdimisht gjatë diskutimeve nga aktorët e shoqërisë civile në lidhje me ndërmarrjen e një qasjeje më të ndjeshme ndaj gjinisë në luftën kundër krimit të organizuar, d.m.th. mungesa e përhapur e fondeve për OJQ-të. Shumë të intervistuar pohonin se, megjithëse prania e komponentit gjinor në punën e tyre shpesh është kriter i donatorit, në realitet, ato nuk e kanë privilegjin të përqendrohen te ndjeshmëritë gjinore ashtu siç u kërkohej në kuadër të aplikimit për lloje të ndryshme projektesh, duke ndjekur shpesh thashethemet e ditës në komunitetin ndërkombëtar dhe jo aq nevojat lokale. Një grup të rinjsh nga Mostari shpjegonte se “këto ditë, OSHC-të janë të detyruara të aplikojnë në shpallje për fonde/propozime vetëm që të mbijetojnë. Por fokusi te parandalimi i krimit dhe te çështjet gjinore mungon. Nëse do të ekzistojë mundësia për të shqyrtuar nevojat me bazë gjinore, organizata jonë do të mund të ndërmarrë nisma të posaçme”.⁵⁸ Një tjetër sfidë është mungesa e udhëzuesve për gjininë dhe krimin e organizuar, sidomos në gjuhët lokale të vendeve të Ballkanit, dhe fakti që kapaciteti i shoqërisë civile për të ofruar veprimtari të specializuara për grupe të ndryshme përfituesish është i kufizuar. Shumë organizata, sidomos në komunitetet më të vogla, kanë vetëm një grusht punonjësish. Të rinjtë ambiciozë shpesh largohen për të punuar në qytete më të mëdha, ku shpresojnë të gjejnë mundësi punësimi të qëndrueshëm.



Një OJQ në Beograd ka nisur një program të posaçëm riintegrimi për ish të burgosurat femra të udhëhequr tërësisht nga femrat. © Officer Bimbleberry nëpërmjet Wikipedia



Një aktiviste e shoqërisë civile duke diskutuar tendencat e krimit të organizuar me të rinjtë e rrezikuar në Shqipëri.
© Qendra Rinore Vlorë

ROLI I GRAVE NË OSHC

Duke kuptuar faktorët nxitës të krimit të organizuar ndihmojmë në zbërthimin e përbërësve të ndryshëm të tij dhe në ofrimin e mundësisë që komunitetet më të prekura nga krimi i organizuar të reagojnë si duhet dhe të krijojnë qëndrueshmëri. Ndonëse angazhimi në krimin e organizuar shpeshherë i vishet presionit shoqëror dhe pritshmërive me bazë në rolet gjinore tradicionale, në kapitullin e mëparshëm pamë se gjinia është përbërës po aq i rëndësishëm në reagimet e shoqërisë civile në drejtim të adresimit të dobësive përballë krimit të organizuar. Gjinia luan rol të rëndësishëm edhe në drejtimin e OSHC-ve.

Gratë janë në krye të shumë OSHC-ve në Ballkanin Perëndimor (sikurse edhe në pjesë të tjera të botës). Ato janë agjente ndryshimi dhe burime qëndrueshmërie në adresimin e dobësive që ndërlidhen me krimin e organizuar dhe korrupsionin. Sikurse tregohet në figurën 4, ato punojnë me fëmijët dhe të rinjtë për të rritur vetëdijesimin lidhur me rreziqet e krimit të organizuar dhe me përdoruesit e drogës ose viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Gjithashtu, ato raportojnë nga “frontet” lidhur me prirjet aktuale në shpërndarjen dhe përdorimin e drogës. Megjithatë të dhënat lidhur me personat që punojnë për OSHC-të janë të kufizuara, duke qenë se regjistrat dhe bazat kombëtare të të dhënave janë të vjetërsuara dhe nuk përmbajnë informacione të sakta për profilin e personelit, raporti i grave ndaj burrave që punojnë në shoqërinë civile është rreth 55:45.⁵⁹

GRATË NË FRONTIN E QËNDRUESHMËRISË NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR



Në Kosovë, organizatat e shoqërisë civile, të drejtuara nga gra, po ngrenë zërin për të raportuar korrupsionin dhe për t'i nxitur komunitetet të bëjnë hapa përpara.




SHQIPËRIA



Në Shqipëri, gratë po drejtojnë qendrat rinore për të rritur vetëdijesimin rreth dobësive që ndërlidhen me kultivimin e kanabisit dhe për t'i ofruar rinisë së rrezikuar mundësi punësimi alternativ.


Në Malin e Zi, "Fondi i Qëndrueshmërisë" po mbështet një organizatë gazetarësh, e drejtuar nga gra, e cila është duke punuar për të zbardhur rolin e burrave dhe grave në krimin e organizuar në mbarë vendin.



Në Mal të Zi, gratë janë në krye të veprimtarive për të ndihmuar individët që përdorin drogë.



Në Bosnjë, gratë po punojnë me fëmijët për të luftuar delikuencën e të miturve dhe huliganizmin.



Të gjithë përfaqësuesit e intervistuar të shoqërisë civile ranë dakord se gratë pranohen dhe vlerësohen në mbarë shoqërinë civile. Në të vërtetë, edhe pse shoqëria e Ballkanit Perëndimor shpesh konsiderohet me orientim mashkullor ose patriarkal, shpesh janë gratë ato që janë duke udhëhequr me guxim lëvizjet e organizatave bazë në drejtim të fuqizimit të qëndrueshmërisë në komunitetet e tyre, duke përfshirë edhe qëndrueshmërinë ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Megjithatë, gratë në shoqërinë civile përballen me sfida specifike, ku përfshihen mungesa e ekspertizës rreth çështjeve të krimit dhe korrupsionit dhe shqetësimet specifike për sigurinë. Një përfaqësuese e shoqërisë civile nga Kosova argumentoi se ndonjëherë gratë hezitojnë të marrin përsipër tema sfiduese, si krimi i organizuar dhe korrupsioni, përveç nëse fokusi është specifikisht te gjinia.⁶⁰ Perceptimi tradicional është që gratë nuk pritët të udhëheqin lëvizjet sociale ose të nxisin zhvillimin ekonomik. Është e vështirë të manovrosh midis këtyre kufizimeve sidomos në vende ku hapësira për shoqërinë civile është duke u tkurrur ose aty ku qeveritë përdorin organizata joqeveritare të organizuara nga qeveria (OJQOQ) për të çuar përpara interesat e tyre, duke dëmtuar në këtë mënyrë besimin e komunitetit dhe të shoqërisë civile të pavarur.



GRATË NË “FRONT” TË HETIMIT TË KRIMIT TË ORGANIZUAR

Numri i grave që raportojnë se ishin gazetarë investigativë në Ballkanin Perëndimor ishte më i vogël sesa i burrave, por ato luajnë një rol kyç në hedhjen dritë mbi krimin e organizuar dhe në dëgjimin e shqetësimeve të komuniteteve të tyre. Dy gra të guximshme në frontin e rritjes së vetëdijesimit të publikut janë Tatjana Lazareviçi, kryeredaktore e portalit “KosSev” nga Mitrovica e Kosovës dhe Brankica Stankoviçi, redaktore e programit dokumentar “Insider” [“insajder”] në stacionin televiziv “B92” në Serbi. Ka shumë të tjera në mbarë rajonin që ndjekin dhe hetojnë hapat e krimit të organizuar dhe korrupsionit në komunitetet e tyre.

Ndonëse ka pasur vetëm disa raste të kërcënimit të drejtpërdrejt të OSHC-ve nga krimi i organizuar, situata është e ndryshme për shumë gazetarë. Të dyja, edhe Lazareviçi, edhe Stankoviçi, kanë marrë kërcënime. Në fakt, Brankica Stankoviçi ka jetuar nën mbrojtjen e policisë për më shumë se pesë vjet, pas kërcënimeve të vazhdueshme nga vrasësit dhe rrjetet kriminale të mbështetura në lëvizjet e huliganëve.⁶¹ Në prill të vitit 2020, Lazareviçi u arrestua për një kohë të shkurtër pas pretendimeve se kishte shkelur shtetrrëhimin gjatë pandemisë “COVID-19” dhe tani po përballët me akuza penale.⁶² Gjithashtu, kërcënimet e dërguara përmes rrjeteve sociale dhe lajmet e rreme janë bërë shqetësim sidomos për personat që merren me problematikat që kanë të bëjnë me korrupsionin dhe krimin mjedisor.⁶³

Pavarësisht këtyre sfidave, ekzistojnë edhe mundësi për gratë në shoqërinë civile. Gratë shihen si veçanërisht novatore në ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme dhe mirëbesimit me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese dhe në avokimin për një rol më të gjerë të shoqërisë civile në komunitet. Ato janë çelësi për nxitjen e rolit të arsimit, fuqizimit të të rinjve dhe barazisë gjinore në zvogëlimin e cenueshmërisë/dobësisë ndaj krimit të organizuar.

Gratë, sidomos drejtueset e qendrave të të rinjve, shpesh shihen si role-model për komunitetet. “Idetë dhe energjia e të rinjve në Vlorë janë burimi i frymëzimit tim të përditshëm”, tha Alekta Lamani, udhëheqëse e një qendre rinore në Vlorë të Shqipërisë, e cila i ofron rinisë lokale shtigje alternative për të ardhmen. Ajo argumenton se edhe pse është e rëndësishme që projektet të zbatohen dhe organizata të vazhdojë të punojë, është jetike “të mos harrohet se ne mund t’ua ndryshojmë jetën të rinjve”.⁶⁴ Lamani është thjesht një prej shembujve të shumtë në Ballkanin Perëndimor që meriton vlerësim, pasi këta shembuj janë tepër të rëndësishëm për motivimin dhe inkurajimin e të rinjve e të rejave që të marrin pjesë dhe të jenë aktive në komunitetet e tyre.

Megjithatë, në kuadër të analizimit të mënyrës si të shfrytëzohen rolet e grave për zbutjen e cenueshmërisë/dobësisë ndaj krimit të organizuar dhe si të fuqizohen njerëzit në komunitetet e tyre, është e rëndësishme që të merret parasysh edhe ajo nëse kuadrot aktuale të qëndrueshmërisë i ngulisin pabarazitë ekzistuese dhe rrisin barrën mbi gratë. Me fjalë të tjera, ne duhet të shmangim rrezikun e ushtrimit të presionit të tepërt mbi OSHC-të që të merren me krimin e organizuar, duke shtuar kështu rreziqet për gratë e guximshme që janë duke u përpjekur të bëjnë gjënë “e duhur” në komunitetet e tyre. Në vend të kësaj, qeveritë lokale dhe kombëtare në Ballkanin Perëndimor duhet të komunikojnë me OSHC-të e drejtuara nga gratë si partnere dhe aleate në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në të njëjtën kohë, donatorët duhet të mbështesin dhe fuqizojnë punën e tyre të rëndësishme, e cila ndikon aq shumë në ndërtimin e qëndrueshmërisë të komunitetet e cenueshme.

Gratë janë në krye të shumë OSHC-ve në Ballkanin Perëndimor.



Pjesëmarrësit në një ngjarje komunitare të mbajtur për të diskutuar mbi përdorimin e drogës në Shtip, Maqedonia e Veriut.

© Shpresa e Dyfishtë

E ARDHMJA

Roli i gjinisë në krimin e organizuar është i rëndësishëm, por nuk kuptohet mirë. Prandaj, siç është treguar në këtë studim, është e rëndësishme të kuptohen më mirë faktorët që nxisin dhe mundësojnë krimin e organizuar dhe të përmirësohet reagimi i shoqërisë civile ndaj kësaj dukurie.

Në të ardhmen, është e rëndësishme të njihet roli i shumanshëm që luajnë gratë në luftën kundër krimit të organizuar dhe në kryerjen e tij dhe të pranohet se disa gra nuk janë spektatore pasive në aktivitetet e krimit të organizuar, por luajnë role qendrore si vepruese në veprimtaritë e krimit të organizuar. Më tej, është jetike të kuptohen dhe neutralizohen rol-modelet negative që tërheqin të rinjtë, gra dhe burra, drejt krimit të organizuar. Një qasje e tillë duhet të ndihmojë në uljen e rreziqeve ndaj grave edhe si viktima të mundshme edhe si autore të krimit të organizuar dhe në adresimin e rreziqeve të mashkullorësisë toksike në mënyrë të tillë që të ndihmohet në zvogëlimin e dobësisë përballë krimit të organizuar. Një qasje e përqendruar te gjinia do të fuqizonte edhe udhëheqëset e shoqërisë civile të cilat shpesh janë në frontet e trajtimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit në komunitet.


SHËNIME

- 1 Kristina Amerhauser dhe Walter Kemp, "Së bashku jemi më të fortë: Forcimi i qëndresës së shoqërisë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor, GI-TOC, mars 2021, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/03/CSO-WBalkans1_ALBANIAN-WEB-2603.pdf.
- 2 Lucia Bird, Rethinking resilience. The role of women in community responses to organized crime [Të rimendosh qëndrueshmërinë: Roli i grave në reagimet e komunitetit ndaj krimit të organizuar], GI-TOC, maj 2021, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/05/Rethinking-Resilience-The-role-of-women-in-community-responses-to-organized-crime-GITOC-Resilience-Fund.pdf>.
- 3 SEE-Obs, Buletini i Rrezeqeve, numri 2, tetor-nëntor 2020, GI-TOC, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/11/SEE-Obs-Risk-Bulletin-2.pdf>; SEE-Obs, Buletini i Rrezeqeve, numri 9, shtator 2021, GI-TOC, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/10/WB-RB09-ENGLISH-WEB-30Sep2021.pdf>.
- 4 Përfundimet e diskutimit në takimin e grupit të ekspertëve lidhur me metodologjitë kërkimore në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit në Ballkanin Perëndimor, shtator 2021, Zagreb, Kroaci.
- 5 Gender and Serious and Organised Crime, Stabilisation Unit Guidance Note for HMG, Stabilisation Unit, United Kingdom, April 2020 [Gjinia dhe Krimi i Organizuar dhe Krimet e Rënda, Shënimi Udhëzues i Njesisë së Stabilizimit për HMG-në, Njësia e Stabilizimit, Mbretëria e Bashkuar, prill 2020].
- 6 UN Office on Drugs and Crime (UNODC), Measuring organized crime in the Western Balkans [Matja e Krimit të Organizuar në Ballkanin Perëndimor], 2020, <https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/OC/Measuring-OC-in-WB.pdf>.
- 7 Lufta malazeze e drogës ka të bëjë me një mosmarrëveshje midis klaneve Kovaçi dhe Shkaljari të Malit të Zi, e cila filloi në vitin 2014 për shkak të mungesës së një dërgese kokaine. Për listën e vrasjeve të lidhura me këtë mosmarrëveshje, shihni "Crna Knjiga, KRIK/ Radio "Evropa e Lirë", <https://www.crnaknjiga.rs/>.
- 8 Gender and Serious and Organised Crime, Stabilisation Unit Guidance Note for HMG, Stabilisation Unit, United Kingdom, April 2020 [Gjinia dhe Krimi i Organizuar dhe Krimet e Rënda, Shënimi Udhëzues i Njesisë së Stabilizimit për HMG-në, Njësia e Stabilizimit, Mbretëria e Bashkuar, prill 2020]. R Haines dhe T O'Neil, Putting gender in political economy analysis: Why it matters and how to do it, [Të vësh gjininë në analizën e ekonomisë politike: Pse është e rëndësishme dhe si të realizohet], Gender and Development Network, maj 2018, <https://gadnetwork.org/gadn-resources/2018/5/9/putting-gender-in-political-economy-analysis-why-it-matters-and-how-to-do-it>.
- 9 Shih edhe: Gender and Serious and Organised Crime, Stabilisation Unit Guidance Note for HMG, Stabilisation Unit, United Kingdom, April 2020 [Gjinia dhe Krimi i Organizuar dhe Krimet e Rënda, Shënimi Udhëzues i Njesisë së Stabilizimit për HMG-në, Njësia e Stabilizimit, Mbretëria e Bashkuar, prill 2020].
- 10 Referencat për Kosovën në këtë raport janë bërë pa paragjykuar qëndrimet për statusin dhe janë në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe opinionin këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.
- 11 Bojan Dobovšek dhe Boštjan Slak, Women and Children at the Centre of Preventing Organised Crime [Gratë dhe fëmijët në Qendrën për Parandalimin e Krimit të Organizuar]. Te: H Kury, S Redo dhe E Shea (eds.), *Women and Children as Victims and Offenders: Background, Prevention, Reintegration* [Gratë dhe fëmijët si viktima dhe autorë krimi: Historiku, parandalimi, integrimi]. Springer, 2016, 557–573.
- 12 Përfundime të nxjerra nga intervistat me përfaqësues të shoqërisë civile dhe fokus

- grupet në Shqipëri (nëntor 2020), Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Maqedoni të Veriut, tetor dhe nëntor 2021.
- 13 Diskutim në fokus grup në Shqipëri, nëntor 2020 dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, nëntor 2021.
 - 14 Intervistë me një gazetar investigativ në Shqipëri, nëntor 2021. Për të mësuar më shumë lidhur me rolin që luan muzika në krimin e organizuar, shihni: Elena Krstanović, *Crimen et Circenses: Serbian Turbo folk music and organised crime* [Muzika turbofolk serbe dhe krimi i organizuar]. Te: D Siegel dhe F Bovenkerk (eds.), *Crime and Music* [Krimi dhe muzika]. Springer, 2021, 149–167.
 - 15 Intervistë me Ivan Gjorgjevićin, Instituti Etnografik Beograd, Serbi, korrik 2021.
 - 16 Shihni edhe: Carlo Morselli dhe David Décary-Héty, *Crime facilitation purposes of social networking sites: A review and analysis of the 'cyberbanging' phenomenon* [Qëllimet e medias sociale në lehtësimin e krimit: Shqyrtim dhe analizë e dukurisë së "luftërave kibernetike"], *Small Wars and Insurgencies*, 41, 1, 152–170, <https://doi.org/10.1080/09592318.2013.740232>.
 - 17 Kristina Amerhauser dhe Walter Kemp, "Së bashku jemi më të fortë: Forcimi i qëndresës së shoqërisë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor, GI-TOC, mars 2021, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/03/CSO-WBalkans1_ALBANIAN-WEB-2603.pdf.
 - 18 Përmendja e CV-së në këtë kontekst ka kuptimin e diplomës ose një kualifikimi universitar. Përvoja në artet marcialle, sigurinë private dhe teknologjinë e informacionit konsiderohen si asetë në ekonominë e krimit të organizuar. Fokus grup me të rinjtë në Mostar të Bosnje dhe Hercegovinës, nëntor 2021.
 - 19 Fokus grupe të realizuara në Kukës të Shqipërisë, nëntor 2020.
 - 20 SEE-Obs, "Buletini i rrezikut", numri 2, tetor-nëntor 2020, GI-TOC, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/11/SEE-Obs-Risk-Bulletin-2.pdf>. Kjo konfirmohet edhe nga literatura nga pjesë të tjera të botës, për shembull shihni: Jadrešin dhe Jelena Mustapić, ŽENE KOJE ČINE KAZNENA DJELA, Jeta dhe shkolla: Gazeta për teorinë dhe praktikën e arsimit, 60, 32, 129–135, <https://hrcak.srce.hr/131222>.
 - 21 Organizata Ndërkombëtare e Punës, About the ILO in Bosnia and Herzegovina [Rreth ILO-s në Bosnjë dhe Hercegovinë], maj 2021, https://www.ilo.org/budapest/countries-covered/bosnia-herzegovina/WCMS_471903/lang-en/index.htm.
 - 22 Ia vlen të përmendet se hendeku gjinor i pagave në Shqipëri mbështetet në të dhënat për pagat e deklaruara tek autoritetet tatimore. Për shkak të informalitetit, pagat shpesh raportohen në vlera më të ulëta sesa vlera reale, sidomos për pozitat e larta, të cilat, në përgjithësi, mbahen nga burrat. Për këtë arsye, hendeku gjinor i pagave supozohet të jetë më i lartë. Shihni: Indeksi i Barazisë Gjinore për Republikën e Shqipërisë 2020, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë, http://www.instat.gov.al/media/6657/gender_equality_index_for_the_republic_of_albania_2020_alb.pdf.
 - 23 Organizata Ndërkombëtare e Punës, *Decent Work Country Programme 2019–2021* [Programi i vendit për "Punë të denjë" 2019–2021]. Mal i Zi, 2019, https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_mas/---program/documents/genericdocument/wcms_679155.pdf.
 - 24 Mihajlovic: *Gender pay gap up to 16 percent in Serbia* [Hendeku gjinor i pagave deri në 16 përqind në Serbi], N1, 18 shtator 2020, <https://rs.n1info.com/english/news/a641115-mihajlovic-gender-pay-gap-up-to-16-percent-in-serbia/>.
 - 25 Intervistë me një grua nga fshati Zheje, e cila merrej me kultivimin e kanabisit, mars 2020.
 - 26 Fatjona Mejdini, *Cannabis cultivation in Albania. An assessment* [Kultivimi i kanabisit në Shqipëri: Vlerësim], maj 2020, GI-TOC (raport i papublikuar).
 - 27 Është e rëndësishme të pranohet se ky zhvillim ndodh me norma të ndryshme në gjithë rajonin dhe është shumë më i ngadaltë në pjesët rurale. *US Agency for International Development, USAID/ North Macedonia Gender Analysis Report* [Raport për analizën gjinore në Maqedoninë e Veriut], 1 korrik 2019, <https://banyanglobal.com/wp-content/uploads/2019/09/USAID-North-Macedonia-Gender-Analysis-Report.pdf>.
 - 28 Walter Kemp, *Crooked kaleidoscope* [Kaleidoskop i shtrembër], GI-TOC, qershor 2017, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2017/07/OC_balkans.pdf.
 - 29 *Srpkinja na čelu narko-bande: Hapšenje u Španiji, pokrenuta policijska akcija*, 28 shtator 2020, ATV, <https://www.atvbl.com/vijesti/svijet/srpkinja-na-celu-narko-bande-hapšenje-u-spaniji-pokrenuta-policijska-akcija-28-9>.

- 30 UNODC, *Measuring organized crime in the Western Balkans* [Matja e krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor], 2020, <https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/OC/Measuring-OC-in-WB.pdf>.
- 31 Shihni për shembull: *Uhapšana žena: Osumnjičena za posredovanje u vršenju prostitucije*, Vijesti, 31 korrik 2020, <https://www.vijesti.me/vijesti/crna-hronika/456217/uhapsena-zena-osumnjicena-za-posredovanje-u-vrsenju-prostitucije>; *Uhapšana Podgoričanka: Osumnjičena za trgovinu ljudima i posredovanje u prostituciji*, Vijesti, 19 nëntor 2020, <https://www.vijesti.me/vijesti/crna-hronika/487629/uhapsena-podgoricanka-osumnjicena-za-trgovinu-ljudima-i-posredovanje-u-prostituciji>; *POLICIJA UHAPSILA ŽENU POD SUMNJOM DA SE BAVI POSREDOVANJEM U VRŠENJU PROSTITUCIJE*, Kraljevo, 10 shtator 2020, <https://kraljevo.online/2020/09/crna-hronika/uhapena-zena-makro/>; *Sud BiH potvrdio optužnicu protiv starlete Tijane Ajfon*, Radio Sarajevo, 12 dhjetor 2020, <https://radiosarajevo.ba/vijesti/crna-hronika/sud-bih-potvrdio-optužnicu-protiv-starlete-tijane-ajfon/399610>.
- 32 Milica Vojinović, Belivukova supruga i tašta saslušane, braniçe se sa slobode, KRIK, 9 dhjetor 2021, <https://www.krik.rs/belivukova-supruga-i-tasta-saslusane-branice-se-sa-slobode/>. Roli i grave në pastrimin e parave nuk është diçka e re. Shihni edhe: *Umijesana i državljanka BiH: U mreži Roka Snežiča i novac preduzeća iz Maribora?*, N1 Slovenia, 3 gusht 2021, <https://ba.n1info.com/regija/umijesana-i-drzavljanika-bih-u-mrezi-roka-snezica-i-novac-preduzeca-iz-maribora/>.
- 33 Kjo u raportua edhe në media. Shihni, për shembull: *PROFESORKA IZ BEOGRADA ČLAN MEĐUNARODNE KRIMINALNE GRUPE: Otišla da vidi Višegrad, uhapšana po poternici INTERPOLA!*, Kurir, 25 gusht 2020, <https://www.kurir.rs/crna-hronika/3520403/profesorka-iz-beograda-clan-medjunarodne-kriminalne-grupe-otisla-da-vidi-visegrad-uhapsena-po-poternici-interpol>.
- 34 Rast i paraqitur në takimin e UNODC-së në Shkup, dhjetor 2021. Shihni edhe: *Продолжува истрагата за заплнетите 700 килограми кокаин во Шпанија*, Sitel, 20 dhjetor 2019, <https://sitel.com.mk/prodolzhuva-istragata-za-zaplenetite-700-kilogrami-kokain-vo-shpanija>.
- 35 *Demography and Social Statistics. Adult Perpetrators of Criminal Offenses in Bosnia and Herzegovina* [Autorët e rritur të veprave penale në Bosnjë dhe Hercegovinë], 2020, Agjencia për Statistika e Bosnje dhe Hercegovinës, 31 gusht 2021, https://bhas.gov.ba/data/Publikacije/Saopštenja/2021/CRI_02_2020_Y1_1_BS.pdf.
- 36 UNODC, *Measuring organized crime in the Western Balkans* [Matja e krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor], 2020, <https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/OC/Measuring-OC-in-WB.pdf>.
- 37 Ky përfundim mbështetet në shqyrtimin e statistikave zyrtare të siguruar nga autoritetet kombëtare. Autorët e pranojnë se ky përfundim përplasht me gjetjet e raportit të vitit 2020 të UNODC-së "Matja e krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor", <https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/OC/Measuring-OC-in-WB.pdf>.
- 38 Nga të gjithë të burgosurit në Shqipëri, 1,8% janë gra. Megjithatë, 3,5% e atyre që kanë kryer veprën e mashtrimit janë gra. Shihni: "Gratë dhe burrat në Shqipëri", Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë, 2021, <http://www.instat.gov.al/media/8713/burra-dhe-gra.pdf>; "Gratë dhe Burrat në Republikën e Serbisë", Zyra e Statistikave të Republikës së Serbisë, 2020, <https://publikacije.stat.gov.rs/G2021/PdfE/G20216001.pdf>.
- 39 Referencat për Kosovën në këtë raport janë bërë pa cenuar pozicionet lidhur me statusin e vendit dhe janë në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe me opinionin këshillimor të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me shpalljen e pavarësisë nga Kosova.
- 40 Për të mësuar më shumë, shihni: Felice Carabellese et al., *The psychopathic dimension in women of mafia* [Dimensioni psikopatik te gratë e mafies], *International Journal of Law and Psychiatry*, 74, 2–3, https://www.researchgate.net/publication/348680403_The_psychopathic_dimension_in_women_of_mafia; Felice Carabellese et al., *Women and men of mafia between traditional cultural contexts and new social roles* [Mafiozet dhe mafiozët midis kuadrit të kulturës tradicionale dhe roleve të reja sociale], *Behavioral Sciences and the Law*, 39, 5, https://www.researchgate.net/publication/354023799_Women_and_men_of_mafia_between_traditional_cultural_contexts_and_new_social_roles.

- 41 Kjo konfirmohet edhe nga statistikën kombëtare për autorët e krimeve dhe të lënduarit.
- 42 Një përjashtim i rrallë është raporti: Lucia Bird, *Rethinking resilience: The role of women in community responses to organized crime* [Të rimendosh qëndrueshmërinë: Roli i grave në reagimet e komunitetit kundër krimit të organizuar], GI-TOC, maj 2021, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/05/Rethinking-Resilience-The-role-of-women-in-community-responses-to-organized-crime-GITOC-Resilience-Fund.pdf>.
- 43 Po aty.
- 44 Rezultatet e një ankete në internet, të realizuar nga GI-TOC-ja me përfutjesit e granteve të Fondit të Qëndrueshmërisë në nëntor të vitit 2021.
- 45 Po aty.
- 46 Intervistë me një përfaqësues të shoqërisë civile në Tetovë të Maqedonisë së Veriut, nëntor 2021.
- 47 Klubi i sportit është shumë i suksesshëm: edhe studentët, edhe studentet e tij janë duke fituar trofe në nivel kombëtar. Intervistë me përfaqësues të klubit në Shqipëri, nëntor dhe dhjetor 2021.
- 48 Intervistë me një përfaqësues të shoqërisë civile në Mostar të Bosnjë dhe Hercegovinës, dhjetor 2021.
- 49 Fokus grup me të rinj në Bosnjë dhe Hercegovinë, nëntor 2021.
- 50 Pohim në një fokus grup me të rinj nga Kamza e Shqipërisë, nëntor 2020.
- 51 Intervistë me një përfaqësues të shoqërisë civile në Maqedoninë e Veriut, tetor 2021.
- 52 Intervistë me Darjan Vuleviçin, Qendra për Parandalimin e Krimeve dhe Ndihmës Postpenale "Neostart", dhjetor 2021.
- 53 Po aty.
- 54 *Women and men in the Republic of Serbia* [Gratë dhe burrat në Republikën e Serbisë], UN Women, 2020, <https://publikacije.stat.gov.rs/G2021/PdfE/G20216001.pdf>.
- 55 Gratë dhe burrat në Shqipëri, 2021, Instat, <http://www.instat.gov.al/media/8713/burra-dhe-gra.pdf>.
- 56 Ivan Katavic, Milorad Milojevic, Svaka treća žena u BiH žrtva nasilja u porodici, zakoni o njihovoj zaštiti 'mrtvo slovo' na papiru, Radio Free Europe, 27 janar 2021, <https://www.slobodnaevropa.org/a/nasilje-u-porodici-u-bih-zakoni-o-zastiti/31072664.html>.
- 57 Kristina Amerhauser dhe Walter Kemp, „Së bashku jemi më të fortë: Forcimi i qëndresës së shoqërisë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor, GI-TOC, mars 2021, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/03/CSO-WBalkans1_ALBANIAN-WEB-2603.pdf.
- 58 Fokus grup i realizuar me të rinjtë në Mostar të Bosnjë dhe Hercegovinës, nëntor 2021.
- 59 Kristina Amerhauser dhe Walter Kemp, „Së bashku jemi më të fortë: Forcimi i qëndresës së shoqërisë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor, GI-TOC, mars 2021, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/03/CSO-WBalkans1_ALBANIAN-WEB-2603.pdf.
- 60 Intervistë me një përfaqësues të shoqërisë civile në Kosovë, dhjetor 2021.
- 61 BRANKICA STANKOVIC, *Serbia: The fight for truth, A heart that never dies* [Serbi: Lufta për të vërtetën: një zemër që nuk vdes kurrë], pa datë, <http://www.ahearththatneverdies.tv/brankica-stankovic/>; Ivana Milanovic Hrasovec, *An entire life in an extraordinary state* [Një jetë e tërë në një shtet të jashtëzakonshëm], Kossev, 10 shkurt 2019, <https://kossev.info/an-entire-life-in-an-extraordinary-state/>.
- 62 OSBE, *OSCE Media Freedom Representative concerned about pressure on KoSsev online portal and its editor-in-chief in Kosovo* [Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medies shpreh shqetësime për presionin mbi portalin në internet "KoSev" dhe kryeredaktores në Kosovë], 12 prill 2020, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/450085>.
- 63 Intervistë me një përfaqësues të shoqërisë civile në Kosovë, dhjetor 2021.
- 64 Intervistë me Alekta Limanin në Shqipëri, dhjetor 2021.



resiliencefund.globalinitiative.net

